



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës
Skupština Opština
Municipal Assambly

Kryetari i Komunës
01.Nr. 67901-1975 /20
Kaçanik, 19.02.2020

Komuna e Kaçanikut, bazuar në buxhetin e miratuar të Kuvendit të Komunës, për vitin 2020, si dhe Rregullores Nr.06/2016 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, Komuna e Kaçanikut, shpallë:

KONKURS PËR NDARJEN E BURSIVE PËR VITIN AKADEMIK 2019-2020

1. Komuna e Kaçanikut, për vitin akademik 2019-2020, do të ndan 50 bursa me nga 40 € në muaj (për 10 muaj) për student të rregullt të studimeve themelore.

Për të aplikuar për bursë, studentët duhen t'i plotësojnë këto kushte:

- 1.1 të jenë banorë të Komunës së Kaçanikut,
- 1.2 të jenë student të rregullt të Universiteteve Publike të Kosovës,
- 1.3 të kenë dhënë të gjitha provimet e vitit paraprak,
- 1.4 të jenë student të vitit të dytë e më lartë,
- 1.5 të mos jenë përsëritës të vitit,
- 1.6 të kenë notën mesatare 7,50 e më lartë, përveç studentëve të profileve deficitare (Fakulteti i Mjekësisë së Përgjithshme, Fakulteti Teknik-Drejtimi Elektro, Arkitekturë dhe Ndërtimtari, FSHMN-Drejtimi Matematikë dhe Fizikë profili arsimor.)

2. Vlerësimi i kandidatëve bëhet me pikë, duke shumëzuar notën mesatare me koeficientin 10.

Studentët përfitojnë pikë tjera në qoftë se i takojnë këtyre kategorive:

- Është fëmijë i kategorive të dala nga lufta (i dëshmorit, i invalidit, i veteranit, i martirit) - i shtohen 2 pikë,
- Është fëmijë nga familja me gjendje të rëndë ekonomike, person me aftësi të kufizuara, - i shtohen 2 pikë,
- dy e më tepër student të një familje - i shtohen 1 pikë.

3. Studentët të cilët i plotësojnë kushtet e këtij konkursi duhet t'i paraqesin këto dokumente:

- 3.1 kërkesa për bursë,
- 3.2 kopje e dokumentit të identifikimit,
- 3.3 dëshmia e regjistrimit të vitit akademik 2019-20,
- 3.4 certifikata e provimeve të dhëna origjinal dhe kopjen e indeksit,
- 3.5 deklarata e bashkësisë familjare, ekstraktin e lindjes,
- 3.6 dëshminë se nuk ka vit të përsëritur gjatë studimeve,
- 3.7 dëshmi që i takon kategorisë sipas pikës 2.

Afati dhe mënyra e aplikimit.

Marrja dhe dorëzimi i aplikacioneve bëhet në objektin e Komunës së Kaçanikut, Zyra pritëse (sporteli nr. 5 nga ora 08:00-16:00 çdo ditë pune.)

Afati për aplikim është 15 ditë pune, nga dita e shpalljes së këtij konkursi prej **19.02/2020 deri 04.03/2020.**

Vërejte: Aplikuesi nuk mund të jetë përfitues i bursës nëse brenda vitit të njëjtë ka qenë përfitues i një burse të ndarë nga pushteti qendror ose ndonjë donator tjetër për fushën e mëtejshme të studimeve.

Prej një familje mund të jetë përfitues vetëm një student.

